

Thirrje për Ekspertë

“Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë”

Qëllimi i ekspertizës	Ekspert për ofrimin e trajnimeve në koordinim me autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike (AKCESK) për bashkërendimin e punës për të trajtuar në kohë reale nëpërmjet sistemit/platformës së raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme, raportimet e bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet
Zona e zbatimit të projektit	Tiranë, Durrës, Krujë, Elbasan
Data e mundshme e fillimit të ekspertizës	Maj 2024
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon një ekspert në kuadër të zbatimit të projektit **“Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë”**. Eksperti i përzgjedhur angazhohet për të ofruar një cikël trajnimesh për profesionistët e autoriteteve përgjegjëse për sigurinë kibernetike (AKCESK) mbi raportimet e bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet për të trajtuar në kohë reale nëpërmjet sistemit/platformës së raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupe më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabel.

Përshkrimi i aktiviteteve në zbatim të kësaj thirrje:

“Një hapësirë kibernetike më e sigurt dhe resiliente për fëmijët dhe të rinjtë” e zbatuar nga Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS synon të promovojë të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në botën digjitale duke ndërgjegjësuar aktorët publikë si dhe nxitur bashkëpunimin ndërsektorial në 4 Bashkitë, për një mjedis më të sigurt në lundrimin online.

Projekti i zbatuar në 4 Bashki: Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Krujë, zhvillohet me mbështetjen e **“SMART Balkans – Shoqëria Civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” projekt rajonal i zbatuar nga Qendra për promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje**

(CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) të mbështetur financiarisht nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme (NMFA).

Kandidati/ja do të zbatohet në kohë dhe me cilësi aktivitetet e përcaktuara në projekt. Kandidati/ja do të jetë përgjegjës/e për ofrimin e cikleve të trajnimit rreth sigurisë kibernetike rreth raportimit e trajtimit në kohë reale nëpërmjet sistemit/platformës së raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme, raportimet e bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet, duke orientuar profesionistët në këshilla praktike dhe të zbatueshme në përshtatje me kontekstin institucional që përfaqësojnë. Grupi i profesionistëve të cilët parashikohen të jenë pjesë e trajnimeve janë përfaqësues të autoriteteve përgjegjës për sigurinë kibernetike (AKCESK).

Eksperti/ja i/e kontraktuar pritet të:

- Zhvillojë një program për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve, të cilët janë nga sektorë të agjensive përkatëse për sigurinë kibernetike dhe pritet të rrisin nivelin e njohurive në identifikimin dhe parandalimin e formave të abuzimit online të të rinjëve dhe fëmijëve;
- Ofrojë trajnim mbi programin e hartuar tek profesionistët në koordinimin e punës për trajtimin në kohë reale të formave të abuzimit dhe shfrytëzimit online, duke prezantuar një përfaqje holistike të ndikimit të fenomenit në kontekstin shqiptar;
- Realizojë një raport me rekomandime dhe gjetje mbi vlerësimin e realizuar nga trajnimet e zhvilluara për çdo bashki.

Eksperti/ja ka këto përgjegjësi:

- Të bashkëpunojë me ekipin e projektit për procesin e ofrimit të trajnimeve duke dakordësuar për metodologjinë dhe mjetet e nevojshme për realizimin e trajnimeve;
- Paketa e trajnimit do të duhet të propozohet nga ana e ekspertit/es (më poshtë listohet një përmbajtje orientuese e temave si):
 - i. Teknologjia dixhitale, analiza e kontekstit aktual në Shqipëri;
 - ii. Njohja me kuadrin ligjor dhe institucionet përgjegjëse, rolet dhe përgjegjësitë referuar sigurisë kibernetike;
 - iii. Mekanizmi i identifikimit, vlerësimit dhe referimit, elementët që duhet të jenë në vëmendje të çdo profesionisti;
 - iv. Siguria e fëmijëve në internet në ambientet e familjes, shkollës, komunitetit e më gjerë, qasja ekologjike dhe sistematike e këtij fenomeni në shoqërinë tonë;
 - v. Hapat konkrete me të cilat duhet të jetë i pajisur çdo profesionist kur përballet me një fëmijë, i ekspozuar ndaj abuzimit online;
 - vi. Në bazë të gjetjeve të vlerësimit të nevojave do të zhvillohen tema të tjera në vijimësi.
- Të përgatisë pre-test dhe post-test për gjithë paketën e trajnimit
- Eksperti për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të angazhohet për ofrimin e një pakete trajnimi 10 ditore (2 ditë për çdo Bashki) edhe dy ditë për përgatitjen e metodologjisë, guidës së trajnimit dhe raportit përfundimtar për organizimin e trajnimit.
- Të hartojë një raport përfundimtar për të gjithë ecurinë e trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të profesionistëve.

Partnerët dhe bashkëpunëtorët e projektit do të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit sipas përkatësisë së tyre dhe përvojës.

Kualifikimet dhe eksperiencat

- Diplomë universitare në shkencë informatike apo sociale;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile ose angazhime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sigurisë kibernetike (preferohet);
- Të zotërojë aftësi dhe njohuri në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe të mësuarit digjital;
- Të njohë dhe ofrojë trajnime mbi përdorimin e teknologjisë dhe internetit të sigurt, të drejtat e fëmijëve;
- Të jetë njohës/e shumë i/e mirë e paketës ligjore për politikën mbi të drejtat, mbrojtjen e fëmijëve, migrimin, arsimin e kombinuar, planin e veprimit të arsimit për romët dhe egjiptianët, njohurive teknologjike, strategjinë e sigurisë kibernetike dhe e arsimit, etj;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe ndërveprimi në punën në grup, bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kyç;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri të mira të rritjes së fizibilitetit dhe promovimit të aktiviteteve të kryera;
- Të ketë dëshirë për t'u zhvilluar profesionalisht apo të ndajë përvojën e vet profesionale.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Eksperti trajnues/e do të zhvillojë detyrën e tij/saj në përputhje me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Koventën e të Drejtave të Fëmijëve të nënshkruar nga NISMA ARSIS.

Procedura e aplikimit:

Personat e interesuar duhet të dergojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- ofertë financiare

brenda datës 15 Prill 2024 në initiative.arsis@gmail.com, deri në mesnatë .Përzgjedhja e

ekspertit do të bazohet në:

- Relevancën e aplikimit me kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës.
- Përvojën përkatëse
- Ofertën financiare
- Regjistrimin tatimor (I preferueshëm)

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin trajnues për profesionistët në identifikimin e hershëm të abuzimit online- Smart Balkans**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.